



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

*Ministria e Punëve të Jashtme – Ministarstvo Inostranih Poslova – Ministry of Foreign Affairs*

Mbështetur në nenin 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Kosovës dhe Ligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, dhe

Në pajtim me nenin 25 (7) të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007,

Nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 02/2010 PËR PAJISJEN ME ORENDI TË  
BANESAVE PRIVATE TË PËRFAQËSUESVE DIPLOMATIK DHE KONSULLOR**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të përcaktojë listën e pajisjeve të lejuara për furnizim me orendi dhe gjëra të tjera të nevojshme në banesat private të përfaqësuesve diplomatik dhe konsullor.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet për Personelin e Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës, i cili shërben jashtë Kosovës dhe përshkruan listën e pajisjeve të lejuara për furnizim me orendi dhe gjëra të tjera të nevojshme në banesat private të përfaqësuesve diplomatik dhe konsullor.

### Neni 3

#### Pajisja me orendi e banesave të përfaqësuesve diplomatikë dhe konsullorë

1. Me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes efektive të punës së përfaqësuesve diplomatik dhe konsullor dhe me qëllim të sigurimit të përfaqësimit të duhur, ashtu siç përcaktohet në dispozitat ligjore në fuqi, banesat e përfaqësuesve diplomatik dhe konsullor pajisen me orendi, si në vijim:

##### 1.1. Dhoma e gjumit, e cila përfshinë:

Nr.	Përshkrimi	Çmimi për zonën 1	Çmimi për zonën 2	Çmimi për zonën 3
1	Dhoma e gjumit	2,000.00€	1,600.00€	1,280.00€
2	Krevat me dyshek	300.00€	240.00€	192.00€
3	Dy çarçafë, një jastëk, dy batanije, një jorgan (për çdo krevat)	200.00€	160.00€	128.00€
4	Tepih	150.00€	120.00€	96.00€
5	Abazhur	70.00€	56.00€	45.00€

##### 1.2. Dhoma e ndejës, e cila përfshinë:

Nr.	Përshkrimi	Çmimi për zonën 1	Çmimi për zonën 2	Çmimi për zonën 3
1	Komplet kolltukësh	2,500.00€	2,000.00€	1,600.00€
2	Tepih	250.00€	200.00€	160.00€
3	Tavolinë mesi	250.00€	200.00€	160.00€
4	Televizor	800.00€	640.00€	512.00€
5	Tavolinë për TV	200€	160.00€	128.00€
6	Vitrinë për libra	500.00€	400.00€	320.00€

##### 1.3. Dhoma e ngrënies, e cila përfshinë:

Nr.	Përshkrimi	Çmimi për zonën 1	Çmimi për zonën 2	Çmimi për zonën 3
1	Tavolinë kuzhine me 6 karrige	800.00€	640.00€	512.00€
2	Karrige sipas nevojës	80.00€	64.00€	51.00€
3	Frigorifer – Friz	500.00€	400.00€	320.00€
4	Mikrovalë	100.00€	80.00€	64.00€
5	Shporet elektrik me furrë	600.00€	480.00€	384.00€
6	Dollapë për kuzhinë	2,500.00€	2,000.00€	1,600.00€
7	Pajisje kuzhine (pjata, gota, lugë, pirunë, thika, tenxhere dhe të ngjashme)	800.00€	640.00€	512.00€

**Neni 4**  
**Pajisja me gjëra të tjera të nevojshme**

1. Banesat e përfaqësuesve diplomatik dhe konsullor pajisen edhe me gjëra të tjera të nevojshme për banim, si në vijim:

Nr.	Përshkrimi	Çmimi për zonën 1	Çmimi për zonën 2	Çmimi për zonën 3
1	Makinë larëse the tharëse e rrobave	800.00€	640.00€	512.00€
2	Makinë për larjen e enëve	500.00€	400.00€	320.00€
3	Ujti me tavolinë për hekurosje	200.00€	160.00€	128.00€
4	Fshesë me korrent	100.00€	80.00€	64.00€
5	Aparat telefoni fiks	100.00€	80.00€	64.00€
6	Perde për çdo dritare	100.00€	80.00€	64.00€
7	Tavolinë pune	250.00€	200.00€	160.00€
8	Tepih për korridor	100.00€	80.00€	60.00€
9	Orman me varëse për rroba	400.00€	320.00€	256.00€
10	Llambadarë për çdo dhomë	100.00€	80.00€	64.00€

**Neni 5**

Shefi i misionit diplomatik dhe konsullor është përgjegjës për mbajtjen e listës së pajisjes me orendi dhe gjëra të tjera të nevojshme, për secilin përfaqësues diplomatik dhe konsullor, banesa e të cilëve është pajisur me orendi dhe gjëra të tjera të nevojshme.

**Neni 6**  
**Shtojca**

1. Shtojca e bashkëngjitur është pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ.
2. Shtojca e bashkëngjitur ndan në zona, shtetet pranuese, ku në bazë të zonave përcaktohen çmimet maksimale të lejuara për orendi dhe gjëra të tjera në ato shtete pranuese.

**Neni 7**  
**Dispozitat përfundimtare**

1. Të gjitha orenditë dhe gjërat e tjera të nevojshme për banim blihen sipas procedurave të parapara me ligjet në fuqi. Të gjitha procedurat e prokurimit kryhen në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-158 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 2003/17 Për Prokurimin Publik të Ndryshuar me Ligjin Nr. 02/L-99.
2. Të gjitha orenditë dhe gjërat e tjera të nevojshme që blihen për banesat private të përfaqësuesve diplomatik dhe konsullor, sipas këtij Udhëzimi Administrativ, janë pasuri publike dhe menaxhohen në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Për shkak të rëndësisë së funksionit që kryen shefi i misionit diplomatik, banesa e shefit të misionit diplomatik pajiset me orendi, të cilat mund të kalojnë shumat e lejuara maksimale me këtë Udhëzim Administrativ deri në njëzet për qind (20 %).

4. Ky Udhëzim Administrativ është i pavlefshëm në ato raste kur banesat e përfaqësuesve diplomatik dhe konsullor janë të kompletuara me orendi dhe gjëra të tjera të nevojshme për banim.

### **Neni 8** **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Skender Hyseni

Ministër i Punëve të Jashtme

9 shkurt 2010

## Shtojcë

<b>Grupi 1</b>	<b>Grupi 2</b>	<b>Grupi 3</b>
Bernë Cyrih Gjenevë	Ankara	Bogota
Londër	Berlin Frankfurt Shtuttgart	Podgoricë
Stokholm	Bruksel	Sofje
Tokio	Budapest	Shkup
Uashington, D.C. Nju Jork	Hagë	Tiranë
	Lisbonë	Riad
	Paris	
	Pragë	
	Romë	
	Vjenë	
	Zagreb	